



FONDI  
Anëtar i Prva Group

# RAPORTI VJETOR I AUDITUAR 2025

Fondi Slloveno-Kosovar i  
Pensioneve, sh.a.

Rr. Ukshin Hoti. Nr.45/10  
10000 Prishtinë Kosovë

T: + 383 22 00 31

E: [info@fskp.eu](mailto:info@fskp.eu)

I: [www.fskp.eu](http://www.fskp.eu)

# FONDI SLOVENO-KOSOVAR I PENSIONEVE



**FONDI**  
Anëtar i Prva Group  
[www.fskp.eu](http://www.fskp.eu) | 038 220 031

**RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2025**

## Përmbajtja

1. LETËR E PËRBASHKËT E KRYETARIT TË BORDIT DHE DREJTORIT MENAXHUES .....	4
2. VEPRIMTARIA E FSKP-së .....	5
3. KAPITALI AKSIONAR DHE AKSIONARËT .....	5
4. ORGANIZIMI I BIZNESIT.....	6
5. RAPORT MBI PUNËN E BORDIT TË DREJTORËVE DHE KOMITETIT TË AUDITIMIT .....	6
6. PAJTUESHMËRIA .....	7
7. DEKLARATA E PËRGJEGJËSISË E BORDIT MENAXHUES .....	8
8. PËRMBLEDHJE E TREGUESVE KRYESOR NË VITIN 2025.....	9
9. PERFORMANCA NGA KTHIMI I INVESTIMEVE NË PERIUDHËN KOHORE 2007-2025.....	10
10. SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE MË 31.12.2025 .....	11
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31.12.2025	

## 1. LETËR E PËRBASHKËT E KRYETARIT TË BORDIT DHE DREJTORIT MENAXHUES

Të nderuar lexues,

Si kryetar i Bordit Drejtues së bashku me Drejtorin Menaxhues, kemi kënaqësinë të prezantojmë raportin e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2025.

Viti 2025 ishte një vit i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP). Në një ambient financiar global që vazhdoi të karakterizohej nga luhatje në tregjet ndërkombëtare, presione inflacioniste dhe ndryshime në normat e interesit, FSKP arriti të ruajë stabilitetin institucional dhe të vazhdojë misionin e tij për sigurimin e një të ardhmeje më të sigurt pensionale për anëtarët tanë. Përkundër sfidave ekonomike dhe luhatjeve në tregjet financiare ndërkombëtare, FSKP ka vazhduar të menaxhojë me kujdes dhe profesionalizëm kursimet pensionale të anëtarëve tanë, duke u fokusuar në sigurinë e investimeve dhe krijimin e vlerës afatgjatë, me një **normë neto të kthimit vjetor nga investimet prej 5,05% në vitin 2025**, përderisa që nga themelimi i FSKP-së e deri më 31 Dhjetor 2025 **kthimi neto kumulativ ishte 126,37%** duke shënuar një rekord të ri të performancës së investimeve.

Gjatë vitit 2025, Bordi i Drejtorëve ka mbikëqyrur me përgjegjësi të lartë qeverisjen korporative, menaxhimin e riskut dhe zbatimin e objektivave strategjike të Fondit. Fokus i veçantë i është kushtuar ruajtjes së sigurisë së investimeve, diversifikimit të portofolit dhe transparencës ndaj anëtarëve dhe institucioneve mbikëqyrëse.

FSKP vazhdon të operojë në përputhje me standardet rregullative të përcaktuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe në harmoni me praktikën më të mira ndërkombëtare të industrisë pensionale.

Raportet e auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare të publikuara ndër vite tregojnë vazhdimësi në raportimin transparent financiar dhe në funksionimin institucional të Fondit. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me rregullat e BQK-së dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Transparenca dhe llogaridhënia ndaj publikut, veçanërisht ndaj klientëve tanë, mbeten vlerat kryesore të Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve që ne me kujdes të veçantë i kultivojmë ndër vite. Në këtë frymë, kemi përgatitur Raportin Vjetor për vitin 2025 për të paraqitur të dhënat më të rëndësishme rreth veprimtarisë sonë dhe performancës së investimeve.

Për ne, besimi i anëtarëve është vlera më e rëndësishme. Prandaj, edhe në të ardhmen do të vazhdojmë të investojmë në profesionalizëm, transparencë dhe inovacion, me qëllim që secili anëtar të ketë siguri më të madhe financiare për periudhën e pensionimit.

Në përfundim, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë anëtarët për besimin e vazhdueshëm, stafin e FSKP-së për angazhimin profesional si dhe institucionet rregullative dhe partnerët tanë për bashkëpunimin korrekt dhe konstruktiv.

## 2. VEPRIMTARIA E FSKP-së

Fondi Slloveno - Kosovar i Pensioneve SH.A është institucion i themeluar dhe licencuar me 14 Nëntor 2006, nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë. FSKP operon në kuadër të Shtyllës së tretë të sistemit Pensional, konkretisht funksionon si Fond Plotësues Vullnetar ku punëdhënësi mund të siguroj në mënyrë vullnetare punonjësit e tij dhe individët mund të sigurojnë pensione individuale. . Shoqëria Aksionare FSKP është krijuar nga PRVA GROUP, Ljubljana dhe Korporata Dukagjini, Pejë me një kapital themelues prej 400,000 (katërqind) mijë EUR. FSKP është anëtare e PRVA GROUP, e cila është themeluar në Dhjetor 2000 me emrin PRVA Pokojninska družba (PRVA Pension Company) si një kompani e specializuar e sigurimeve në Slloveni. Mbi bazën e ekspertizës, njohurive dhe përvojës së kualifikuar, shoqëria e parë pensionale jashtë vendit u krijua në vitin 2004, ndërsa aktualisht kompania Holding e sigurimeve PRVA Group operon në shtetet e listuara më poshtë:

- Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve Sh.A., Prishtinë, Kosovë, sigurim pensional plotësues
- KB Prvo penzisko drustvo AD Shkup, Maqedoni e Veriut, sigurim pensional i detyrueshëm dhe plotësues
- Garant penzijsko društvo a.d., Beograd, Serbi, pensione plotësuese

Deri më 31 Dhjetor, 2025, Prva Group numëron 489 një klient, me 2.14 miliardë euro mjete nën menaxhim. FONDI Slloveno - Kosovar i Pensioneve menaxhon kontributet vullnetare të kursyera nga klientët me qëllim që të krijoj siguri dhe fitim afatgjatë për klientët përmes investimit të mjeteve në tregjet vendore dhe ndërkombëtare. Me qëllim që klientëve tanë të i ofrohet kthim sa më i lartë nga investimet për të ofruar pensionin më të mirë të mundshëm, Fondi minimizon riskun e investimeve duke e diversifikuar portofolin e investimeve të kontributeve personale në tregje dhe industri të ndryshme botërore, në këtë mënyrë shpërndahet dhe zvogëlohet rreziku i mundshëm nga investimet. Investimet realizohen mbi bazën e ekspertizës, njohurive dhe përvojës së Asset Menaxherëve të PRVA GROUP, çdo herë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi të përcaktuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

## 3. KAPITALI AKSIONAR DHE AKSIONARËT

Kapitali aksionar i Kompanisë është 400,000 € dhe nuk ka ndryshuar në vitin 2025.

Pronarët e FSKP sh.a. janë biznese të suksesshme Sllovene dhe vendore. Aksionarët e FSKP Sh.a. janë PRVA Group kompani e sigurimeve me 67.4% si dhe korporata Dukagjini 32.6%.

## 4. ORGANIZIMI I BIZNESIT

Organizimi i Shoqërisë përbëhet nga Kuvendi i Aksionarëve (mbledhja e përgjithshme), Bordi i Drejtorëve, Bordi Menaxhues dhe Komiteti i Auditimit.

Kuvendi i Aksionarëve (mbledhja e përgjithshme) i FSKP-së përbëhet nga persona juridikë dhe fizikë që kanë në pronësi aksionet e FSKP-së.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tre anëtarë. Të gjithë janë përfaqësues të kapitalit.

Bordi Menaxhues përfaqëson dhe prezanton Shoqërinë. Bordi menaxhues i Shoqërisë përbëhet nga Drejtori Menaxhues Z. Bajram Bajrami.

Pronarët e Shoqërisë kanë të drejtë të ndryshojnë pasqyrat financiare pas miratimit të tyre nga Bordi Menaxhues.

## 5. RAPORT MBI PUNËN E BORDIT TË DREJTORËVE DHE KOMITETIT TË AUDITIMIT

Bordi i Drejtorëve prej tre anëtarësh i ka kryer detyrat e tij në përputhje me dispozitat e Ligjit për Fondet Pensionale Ligji Nr. 04/L-101 i Republikës së Kosovës për Fondet Pensionale në Kosovë, bashkë me plotësimet dhe ndryshimet e tij (me Ligjin Nr. 04/L-168, ligjin Nr.04/L-115 dhe Ligjin Nr. 05/ L-116), Ligjin mbi organizimin e shoqërive tregtare në Kosovë, Statutin e Shoqërisë dhe Rregullat e Procedurës për punë të Bordit të Drejtorëve në vitin 2025.

### **BORDI I DREJTORËVE**

Në VITIN 2025, Bordi i Drejtorëve përbëhej nga: Znj. Iris Dežman, Z. Ekrem Lluka dhe Znj. Tea Treven.

### **DETYRAT E BORDIT TË DREJTORËVE**

Bordi i Drejtorëve monitoroi dhe diskutoi funksionimin e Shoqërisë dhe punën e Bordit Menaxhues në katër sesione të rregullta në vitin 2025. Ka kryer legjitimitetin e përshkruar për mbikëqyrjen e operacioneve të Shoqërisë dhe ka mbikëqyrur zbatimin e vendimeve të miratuara në seancat e mëparshme dhe nga Mbledhjet e Përgjithshme të Shoqërisë.

Në vitin 2025 puna e Bordit të Drejtorëve konsistoi më tej në adresimin e Raportit Vjetor të FSKP-së për vitin 2024 dhe Raportet e Komitetit të Auditimit për vitin 2024 dhe 2025, duke adresuar dhe miratuar planin e biznesit për 2026-2028, miratimin e politikës së investimeve për vitin 2026 dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të të gjitha operacioneve të Shoqërisë dhe krahasimi i objektivave të realizuara me ato të planifikuara.

Bordi i Drejtorëve mbikëqyri rregullisht punën e Komitetit të Auditimit dhe gjetjet e tij, siç janë paraqitur në Raportin Vjetor të Komitetit të Auditimit për vitin 2024 dhe në raportet e rregullta të aktivitetit të Komitetit të Auditimit

Në vitin 2025, Bordi Mbikëqyrës miratoi propozimin për thirrjen e Kuvendit të Përgjithshëm Vjetor të Kompanisë.

Në mbledhjen e datës 27 Shkurt, 2026, Bordi i Drejtorëve shqyrtoi Raportin Vjetor të FSKP-së për vitin 2025 për Fund1, Fund 2 dhe Kompaninë me opinionin e auditorit të jashtëm për këto raporte dhe rekomandoi mbledhjen e përgjithshme ta miratojë atë.

## **KOMITETI I AUDITIMIT**

Bordi i Drejtorëve krijoi Komitetin e Auditimit prej tre anëtarësh.

Detyrat dhe kompetencat e Komitetit të Auditimit janë të përcaktuara në Rregulloren për Funkcionimin e Komitetit të Auditimit dhe vendimet e miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

Në vitin 2025, Komiteti i Auditimit trajtoi temat e mëposhtme në katër seanca të rregullta:

- Shqyrtimi i Strategjisë së auditimit të brendshëm për periudhën 2025-2029 dhe adresimin e tij në Bordin e Drejtorëve për miratim.
- Shqyrtimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2026 dhe adresimin e tij në Bordin e Drejtorëve për miratim.
- Përditësimin e statutit të auditimit të brendshëm dhe adresimin e tij në Bordin e Drejtorëve për miratim.
- Emërimi i auditorit të brendshëm dhe propozimi i dërgohet Bordit të Drejtorëve për miratim.

Komiteti i Auditimit nxori një Raport Vjetor për punën e tij të kryer në vitin 2025, i cili, ndër të tjera, përfshin një shqyrtim të opinionit të auditorit të jashtëm për Raportin Vjetor të FSKP-së për vitin 2024 për Fund1, Fund2 dhe Kompaninë dhe rekomandojë Bordit të Drejtorëve ta dërgojë në mbledhjen e përgjithshme për miratim.

## **6. PAJTUESHMËRIA**

Pajtueshmëria me Rregullatorin - FSKP sigurohet që përveç aplikimit të kërkesave rregullative, të krijojë edhe mekanizma të brendshëm duke miratuar procedurën ligjore dhe pajtueshmërinë me qëllim të krijimit të një vendi më të sigurt për klientët, në aspektin e infrastrukturës ligjore.

Mbrojtja e konsumatorëve - FSKP ka në fokus ofrimin e shërbimeve cilësore për klientë dhe në këtë kuadër aplikon të gjitha kërkesat rregullative dhe ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Po ashtu, FSKP i kushton rëndësi të veçantë trajtimit të ankesave të klientëve, të cilat trajtohen me kujdes dhe transparencë të veçantë.

Parandalimi i pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit - Në fushën e parandalimit të pastrimit të parave janë krijuar standarde të larta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Këto standarde janë përgatitur në harmoni të plotë me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Nr. 05 / L-096. Bazuar në legjislacionin e lartpërmendur, FSKP ka miratuar politika dhe procedura të cilat janë në fuqi dhe të cilat theksojnë rëndësinë e krijimit të sistemeve adekuate për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

## 7. DEKLARATA E PËRGJEGJËSISË E BORDIT MENAXHUES

Bordi Menaxhues miratoi publikimin e pasqyrave financiare, politikat kontabël të përdorura dhe shënimet e pasqyrave financiare më 02 Shkurt, 2026.

Bordi Menaxhues është përgjegjës për përgatitjen e raportit vjetor i cili paraqet një të vërtetë dhe pamje të drejtë të pozicionit financiar për Fond1, Fond2 dhe Kompaninë dhe të rezultateve të tyre financiare për vitin 2025.

Bordi Menaxhues konfirmon se pasqyrat financiare të Fund1, Fund2 dhe Kompanisë janë përpiluar nën supozimin e vazhdimësisë, se politikat e duhura kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe se çdo ndryshim është shpalosur, dhe se vlerësimet kontabël janë bërë bazuar në parimin e maturisë dhe kujdesit të duhur.

Bordi Menaxhues është gjithashtu përgjegjës për miratimin e masave për sigurimin e aseteve të FSKP-së, dhe për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimet dhe parregullsitë e tjera dhe/ose veprimet e paligjshme.

Administrata Tatimore mundet në çdo kohë brenda një periudhe 6-vjeçare pas përfundimit të vitit fiskal, të kryejë një kontroll të operacioneve të Kompanisë, i cili mund të çojë në vlerësimin e detyrimeve tatimore shtesë, interesit të vonësës dhe gjobave në lidhje me tatimin mbi të ardhurat e korporatave ose taksat dhe detyrimet e tjera. Bordi Menaxhues nuk ka dijeni për asnjë rrethanë që mund të rezultojë në një detyrim të konsiderueshëm tatimor.

Për më tepër, asnjë transaksion ligjor nuk është ndërmarrë në vitin 2025 dhe asnjë veprim nuk u krye dhe as nuk u hoq, të cilat do të mund të i shkaktojnë dëm Kompanisë.

Prishtinë, 06 Mars 2026

**Bajram Bajrami**  
Managing Director



## 8. PËRMBLEDHJE E TREGUESVE KRYESORË NË VITIN 2025

### PERFORMANCA

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REALIZIMI	-0.68%	1.61%	5.05%	24.90%	22.77%	126.37%
IHÇK	0.70%	1.71%	5.43%	9.05%	30.41%	75.18%

\* Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

### LËVIZJET MUJORE TË ÇMIMIT TË NJËSISË

MUAJI	ÇMIMI I NJËSISË	KTHMI NGA INVESTIMET
Janar	219,74	1,98%
Shkurt	218,78	-0,44%
Mars	209,23	-4,37%
Prill	205,29	-1,88%
Maj	212,39	3,46%
Qershor	213,88	0,70%
Korrik	218,38	2,11%
Gusht	218,66	0,13%
Shtator	222,79	1,89%
Tetor	228,40	2,52%
Nëntor	227,92	-0,21%
Dhjetor	226,37	-0,68%


### KONTRIBUTET

KONTRIBUTET (EUR)	
TM1 (2025)	220.165 €
TM2 (2025)	168.390 €
TM3 (2025)	175.558 €
TM4 (2025)	212.935 €
Gjithsej	777.048 €

### PENSIONET E PAGUARA

PENSIONET E PAGUARA (EUR)	
TM1 (2025)	98.502 €
TM2 (2025)	116.815 €
TM3 (2025)	107.086 €
TM4 (2025)	107.617 €
Gjithsej	430.021 €

## 9. PERFORMANCA NGA KTHIMI I INVESTIMEVE NË PERIUDHËN KOHORE 2007-2025



\* Çmimi i njësisë i FSKP-së nga fillimi deri më 31.12.2025

Performanca e investimeve të Fondit Slloveno - Kosovar të Pensioneve për vitin 2025 ishte 5.05%. FONDI ka arritur të realizoj kthim të kënaqshëm pozitiv që nga themelimi, ku prej vitit 2007 deri në Dhjetor të vitit 2025 kthimi kumulativ ishte në nivel prej 126.37%.

## 10. SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE MË 31.12.2025

### INVESTIMET E FOND1 MË 31.12.2025

Institucioni	Numri ISIN	Investimet më 31.12.2025
SPDR S&P 500 ETF TRUST	US78462F1030	714.420
ISHARES RUSSELL 3000 ETF	US4642876894	456.648
BLACKROCK INC	IE0032523478	1.076.150
ISHARES MSCI EMERGING MARKET	US4642872349	183.220
VANGUARD LARGE CAP ETF	US9229086379	474.209
THE VANGUARD GROUP	US9220428588	194.314
BLACKROCK INC	IE00B0M62X26	134.000
LYXOR INTERNATIONAL ASSET MANAGEMENT	FR0007054358	293.783
BLACKROCK FUND ADVISOR	US4642872000	730.408
VANGUARD FTSE PACIFIC ETF	US9220428661	239.425
DB X-TRACKERS MSCI EMERGING MARKETS	LU0292107645	120.693
SOURCE STOXX EUROPE 600 UCIT	IE00B60SWW18	245.998
DBX STX EUROPE 600 (DR)	LU0328475792	297.673
VANGUARD S&P 500 ETF	US9229083632	526.789
BLACKROCK INC	IE00B66F4759	273.142
ISHARES MSCI EUROPE SRI	IE00B52VJ196	197.175
DBX II IBX SOV EUROZONE	LU0290355717	316.749
ISHARES JPM USD EM BND EUR-H	IE00B9M6RS56	300.547
ISHARES STOXX EUROPE 600 DE	DE0002635307	195.255
ISHARES CORE MSCI PADIFIC ET	US46434V6965	129.847
ISHARES MSCI EM SRI UCITS ETF	IE00BYVJRP78	66.570
ISHARES MSCI JAPAN SRI UCITS E	IE00BYX8XC17	64.436
XTRACKERS ARTIFICIAL INTELLIGENCE AND BIG DATA UCITS ETF	IE00BGV5VN51	152.293
INVESCO MARKETS PLC - INVESCO	IE00BKS7L097	497.615
PACER US SMALL CAP CASH COWS 1	US69374H8575	93.271
VANECK SEMICONDUCTOR ETF	US92189F6768	87.351
ISHARES MSCI CANADA UCITS ETF	IE00B52SF786	152.007
XTRACKERS MSCI WORLD HEALTH CARE	IE00BM67HK77	50.591
ISHARES CORE EM IMI UCITS ETF	IE00BKM4GZ66	133.371
INVESCO COINSHARES GLOBAL BLOC	IE00BGBN6P67	53.993
THESARI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	LETRA ME VLERË TË QEVERISË	1.391.943
REPUBLIKA HELENE	LETRA ME VLERË TË QEVERISË	38.622
ROMANI	LETRA ME VLERË TË QEVERISË	101.371
INDUSTRIA SLOVENE	SI0032104489	162.992
EMIRATES TELECOM CORP	XS1077882394	101.361
BANKA NË KOSOVË	DEPOZITA BANKARE	252.199
BANKA	PARAJA NË BANKA	175.428
<b>GJITHSEJ</b>		<b>10.675.860</b>

# FONDI SLLOVENO - KOSOVAR I PENSIONEVE SH.A.

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE  
PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN QË  
PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2025**

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve  
Kompania

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

## Përmbajtja

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënime për pasqyrat financiare	7-24

# Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Aksionarët e

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a.

**Grant Thornton LLC**

Rexhep Mala 18

10000 Pristina

Kosovo

**T** +383 (0)38 247 801

**F** +383 (0)38 247 802

**E** [Contact@ks.gt.com](mailto:Contact@ks.gt.com)

VAT No. 330086000

## Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (Kompania), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave materiale të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me SNRF-të, standardet e kontabilitetit siç janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB).

## Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë të sqaruara më tutje në seksionin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante në Kosovë për auditimin tonë të pasqyrave financiare dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit të BSNEK-së. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Informacioni tjetër në Raportin Vjetor

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin e përfshirë në Raportin Vjetor, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të Auditorit të Pavarur mbi to.

Opinionit ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionin tjetër dhe, ne nuk kemi dhe nuk do të shprehim ndonjë lloj përfundimi sigurie për të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër kurdo që na sigurohet në dispozicion, duke bërë kështu, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është në kundërshtim të rëndësishëm me pasqyrat financiare ose me njohuritë tona të fituara në auditim, ose ndryshe duket të jetë gabim material. Kur ne lexojmë raportin vjetor nëse, bazuar në punën që kemi kryer, ne vërejmë se ka një gabim material në këtë informacion tjetër, ne kemi detyrimin të raportojmë atë fakt me personat e ngarkuar me qeverisjen.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, standardet e kontabilitetit siç janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

## Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionin mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Fondi mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të terheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a., përpos të tjerave, lidhur me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**Grant Thornton LLC**  
Prishtinë,  
27 shkurt 2026

  
Suzana Stavrik  
Auditor ligjor



**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - KOMPANIA  
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR  
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>PASURITË</b>			
Paraja dhe Ekuivalentet e parase	4	20,187	30,127
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	5	371,151	371,268
Pasurite financiare te mbajtura sipas vleres se amortizuar	5	14,941	-
Prona dhe e drejta e përdorimit të pasurisë	6	15,973	19,066
Pasuritë e paprekshme	6	975	2,029
Të arkëtueshmet dhe pasuritë tjera	7	29,525	24,727
Parapagimet e tatimit		423	3,931
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>		<b>453,175</b>	<b>451,149</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrimet tregtare dhe të tjera	8	16,244	20,086
Detyrimi i qirasë financiare	9	1,784	9,304
<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>		<b>18,028</b>	<b>29,390</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali Aksionar	10	400,000	400,000
Rezervat e rivlerësimit		(501)	(716)
Fitimet e mbajtura		35,648	22,475
<b>GJITHSEJ KAPITALI</b>		<b>435,147</b>	<b>421,759</b>
<b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		<b>453,175</b>	<b>451,149</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a - më 3 shkurt 2026 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

  
Z. Bajram Bajrami  
Drejtor menaxhues

**FONDI  
SLOVENO-KOSOVAR  
I PENSIONEVE**  
Shoqëri Aksionare-Prishtinë

  
Fatbardhe Kaqanoll  
Kontabiliste e Çertifikuar

Pasqyra e mësipërme e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri 19.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - KOMPANIA  
PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE  
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	2025	2024
<b>TË ARDHURAT</b>			
Tarifa e Menaxhimit nga Fondi 1		152,228	141,175
Tarifa e Menaxhimit nga Fondi 2		11,222	7,142
Tarifa hyrese nga kontributet nga Fondi 1		23,203	20,017
Tarifa dalese nga pensionistet nga Fondi 1		3,846	4,726
Të ardhurat nga interesi	11	13,330	12,643
Fitimet tjera (humbjet)		1,273	337
<b>GJITHSEJ TË ARDHURAT</b>		<b>205,102</b>	<b>186,040</b>
<b>SHPENZIMET</b>			
Shpenzimet operative	12	(190,803)	(174,475)
Shpenzimet e interesit		(208)	(460)
Dëmtimet		-	(49)
<b>GJITHSEJ SHPENZIMET</b>		<b>(191,011)</b>	<b>(174,984)</b>
Fitimi para tatimit		<b>14,091</b>	<b>11,056</b>
Shpenzimet e tatimit në të ardhura	13	(920)	-
<b>(Humbja) / Fitimi i vitit</b>		<b>13,171</b>	<b>11,056</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</b>			
<i>Artikujt që mund të klasifikohen si fitim ose humbje</i>			
Ndryshimet neto në vlerën e drejtë në pasuri financiare përmes OCI		215	(2,389)
<b>GJITHSEJ (HUMBJET)/TË ARDHURAT TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE</b>		<b>13,386</b>	<b>8,667</b>

Pasqyra e mësipërme e fitimit dhe humbjes duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri 19.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - KOMPANIA  
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET  
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezervat e Rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
<b>Më 1 JANAR 2025</b>	<b>400,000</b>	<b>(716)</b>	<b>22,477</b>	<b>421,761</b>
<u>Transaksionet me pronarin</u>	-	-	-	-
<b>Bilanci sipas 1 janar 2025</b>	<b>400,000</b>	<b>(716)</b>	<b>22,477</b>	<b>421,761</b>
Fitimi i vitit	-	-	13,171	13,171
Fitime të tjera gjithëpërfshirëse	-	215	-	215
<b>GJITHSEJ HUMBJET GJITHËPËRFSHIRËSE</b>	<b>-</b>	<b>215</b>	<b>13,171</b>	<b>13,386</b>
<b>Më 31 DHJETOR 2024</b>	<b>400,000</b>	<b>(501)</b>	<b>35,648</b>	<b>435,147</b>
<b>Më 1 JANAR 2024</b>	<b>400,000</b>	<b>1,673</b>	<b>11,421</b>	<b>413,094</b>
<u>Transaksionet me pronarin</u>	-	-	-	-
<b>Gjithsej transaksionet me pronarin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Fitimi i vitit	-	-	11,056	11,056
Humbje të tjera gjithëpërfshirëse	-	(2,389)	-	(2,389)
<b>GJITHSEJ HUMBJET GJITHËPËRFSHIRËSE</b>	<b>-</b>	<b>(2,389)</b>	<b>11,056</b>	<b>8,667</b>
<b>At 31 DECEMBER 2023</b>	<b>400,000</b>	<b>(716)</b>	<b>22,477</b>	<b>421,761</b>

Pasqyra e mësipërme e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri 19.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE – KOMPANIA  
PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË  
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	2025	2024
<b>AKTIVITETET OPERATIVE</b>			
Fitimi para tatimit mbi të ardhurat		14,091	11,056
Rregulluar për:			
Shpenzimet e Zhvlerësimit	6	10,616	9,956
Shpenzimet e Amortizimit	6	1,053	3,867
Të ardhurat nga interesi	11	(13,330)	(12,643)
Shpenzimet e interesit		208	460
Dëmtimet		-	(49)
<i>Të ardhurat operative para ndryshimeve në pasuritë operative</i>		<b>12,638</b>	<b>12,647</b>
Ndryshimet në kapitalin punues:			
Të arkëtueshmet dhe pasuritë tjera		(1,289)	(4,812)
Detyrimet tregtare dhe të tjera		(4,758)	5,581
Interesi i pranuar		13,078	12,670
Interesi i paguar		(208)	(460)
Pagesa e tatimit mbi të ardhurat		(465)	(4)
<b>Paratë e gjeneruara nga aktivitetet operative</b>		<b>12,975</b>	<b>6,358</b>
<b>AKTIVITETET INVESTIVE</b>			
Ndryshimet e investimeve ne FVOCI		(154,689)	(89,621)
Të ardhurat nga shitjet e investimeve të FVOCI		140,225	51,377
Blerja e pajisjeve, impiante dhe pajisjeve	6	(8,056)	-
<b>Paratë e gatshme të përdorura për aktivitete investuese</b>		<b>(22,520)</b>	<b>(38,244)</b>
<b>AKTIVITETET FINANCUESE</b>			
Pagesa e detyrimit të qirasë	9	(6,417)	(5,862)
<b>Paratë e përdorura nga aktivitetet e financimit</b>		<b>(6,417)</b>	<b>(5,862)</b>
<b>NDRYSHIMET NË PARA TË GATSHME DHE EKVIVALENTËT E PARASË</b>		<b>(9,940)</b>	<b>(18,484)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës		30,127	48,611
<b>PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND TË PERIUdhËS</b>	<b>4</b>	<b>20,187</b>	<b>30,127</b>

Pasqyra e mësipërme e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri 19.

# FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - KOMPANIA

## Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 1. Informacione të Përgjithshme

Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tutje referuar si "Kompania" ose "Fondi 1") është themeluar si shoqëri aksionare më 29 gusht 2006 me numër regjistrimi të biznesit 70378739. Kompania ka filluar veprimtarinë e saj më 4 shtator 2006. Zyra e regjistruar ndodhet në Rr. Ukshin Hoti, nr.45/10, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Fondi 1 administrohet dhe menaxhohet nga Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve sh.a. Aksionarët kryesorë të Shoqërisë janë Prva Group PLC, e cila është themeluar në Slloveni me pronësi të 67.4% të aksioneve dhe Korporata Dukagjini në Kosovë me 32.6% të aksioneve. Kompania e fundit amë është kompania slovene Prva Finance d.o.o.

Veprimtaria kryesore e Kompanisë është menaxhimi i fondeve të pensioneve, përfaqësimi i tyre përpara palëve të treta dhe të gjitha aktivitetet e tjera të lidhura me fondet e pensioneve.

Nga fillimi deri në fillimin e vitit 2008, Kompania menaxhon një fond pensioni vullnetar (i referuar më tej si "Fondi 1"). Gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2008, Kompania nënshkroi marrëveshje me Shoqërinë e Pensioneve Shtesë të PTK-së në likuidim (i referuar më tej si "PTK") për menaxhimin e aseteve të tyre dhe pagesën e pensioneve mujore sipas planeve të pensioneve paracaktuar të ofruara nga PTK. Asetet e PTK-së përfshijnë fondin e dytë pensionistik nën menaxhimin e FSKP-së (i referuar më tej si "Fondi 2") dhe kontribuuesit e transferuar nga Fondi 1 pas moshës së pensionimit.

Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve sh.a. - Kompania menaxhon dhe administron Fondin 1 dhe Fondin 2. Në Fondin 1, të gjitha kontributet mbledhen nga anëtarët që nuk kanë pensionuar ende, bazuar në kushtet e pensionimit të përcaktuara në Ligjin për Fondet e Pensioneve në Kosovë. Kur anëtarët pensionohen nga Fondi 1, asetet e tyre transferohen në Fondin 2 bazuar në shumën totale të grumbulluar në llogaritë e tyre individuale. Nëse asetet totale janë më pak se 3,000 euro, anëtarët do të marrin një pagesë të vetme nga Fondi 1. Nëse asetet totale tejkalojnë 3,000 euro, ato transferohen nga Fondi 1 në Fondin 2. Pastaj, anëtarët do të marrin pagesat e tërheqjes fazore në bazë të një plani pagese për tërheqje fazore në bazë mujore nga Fondi 2.

### 2. Politikat Materiale të Kontabilitetit

Politikat kryesore të kontabilitetit të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

#### **Baza e Përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të dala nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- asete financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpëfshirëse (FVOCI) – të matura me vlerën e drejtë.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur politikat materiale të kontabilitetit dhe bazat e matjes të përmbledhura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse caktohet ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabël kritike. Ai gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, monedha e Bashkimit Evropian.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE – KOMPANIA  
PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË  
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025**

*(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

## 2. Politika materiale të kontabilitetit (Vazhdim)

*Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të ndryshuara*

Fondi ka miratuar të gjitha standardet dhe interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Miratimi i këtyre standardeve dhe interpretimi nuk pati ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Fondit.

- Mungesa e këmblyshmërisë (ndryshimet në SNK 21), në fuqi nga 1 janari 2025.

Menaxhmenti ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndikim të rëndësishëm në këto pasqyra financiare.

Standardet e lëshuara, por ende jo në fuqi:

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet dhe ndryshimet e mëposhtme të reja në standardet ekzistuese ishin në fuqi, por ende jo në fuqi:

- Ndryshimi i SNRF 9 dhe SNRF 7 - Klasifikimi dhe Matja e Instrumenteve Financiare, në fuqi nga 1 janari 2026.

- SNRF 18 Paraqitja dhe Shpalosjet në Pasqyrat Financiare, në fuqi nga 1 janari 2027.

- SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike: Shpalosjet, në fuqi nga 1 janari 2027.

Kompania ka zgjedhur të mos i miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave të hyrjes në fuqi të tyre. Kompania parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e zbatimit fillestar.

### ***Mjetet financiare***

#### ***Klasifikimi***

Kompania klasifikon aktivet financiare në kategorinë e mëposhtme të matjes:

- ato që do të maten më pas me vlerën e drejtë (ose nëpërmjet OCI ose nëpërmjet fitimit ose humbjes), dhe
- ato që do të maten me koston e amortizuar.

Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të njësisë ekonomike për administrimin e aktiveve financiare dhe kushtet kontraktuale të flukseve monetare.

Kompania riklasifikon investimet e borxhit kur dhe vetëm kur ndryshon modeli i saj i biznesit për menaxhimin e këtyre aktiveve.

#### ***Njohja dhe mosnjohja***

Blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit, datë në të cilën kompania zotohet të blejë ose shesë aktivin. Aktivet financiare çregjistrohen kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivet financiare kanë skaduar ose janë transferuar dhe kompania ka transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

#### ***Matja***

Në njohjen fillestare, kompania mat një aktiv financiar me vlerën e tij të drejtë plus, në rastin e një aktivi financiar jo me vlerën e tij të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL), koston e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aktivit financiar. Kostot e transaksionit të aktiveve financiare të bartura në FVTPL shpenzohen në fitim ose humbje.

Aktivitetet financiare me derivativë të përfshirë merren parasysh në tërësinë e tyre kur përcaktohet nëse flukset e tyre monetare janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit.

# FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - KOMPANIA

## Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. Politika materiale të kontabilitetit (Vazhdim)

#### Instrumentet e borxhit

Matja e mëvonshme e instrumenteve të borxhit varet nga modeli i biznesit të kompanisë për menaxhimin e aktivitetit dhe karakteristikat e fluksit monetar të aktivitetit. Ekzistojnë tre kategori matjeje në të cilat kompania klasifikon instrumentet e saj të borxhit:

- **Kosto e amortizuar:** Asetet që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ku ato flukse monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit maten me koston e amortizuar. Të ardhurat nga interesi nga këto aktive financiare përfshihen në të ardhurat financiare duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Çdo fitim ose humbje që lind nga mosnjohja njihet drejtpërdrejt në fitim ose humbje dhe paraqitet në fitime/(humbje) të tjera së bashku me fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj. Humbjet nga rënia në vlerë paraqiten si zë të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, të arkëtueshmet për tarifën e menaxhimit, tarifën e hyrjes dhe tarifën e daljes janë riklasifikuar në këtë kategori.

- **FVOCI:** Asetet që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për shitjen e aktiveve financiare, ku flukset monetare të aktiveve përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit, maten me FVOCI. Lëvizjet në vlerën kontabël njihen në OCI, me përjashtim të njohjes së fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi, të ardhurave nga interesi dhe fitimeve dhe humbjeve nga këmbimi valutor, të cilat njihen në fitim ose humbje. Kur aktivi financiar çregjistrohet, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në OCI riklasifikohet nga kapitali në fitim ose humbje dhe njihet në fitime/(humbje) të tjera. Të ardhurat nga interesi nga këto aktive financiare përfshihen në të ardhurat financiare duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj paraqiten në fitime/(humbje) të tjera dhe shpenzimet e zhvlerësimit paraqiten si zë të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse janë klasifikuar në këtë kategori.

- **FVTPL:** Asetet që nuk plotësojnë kriteret për koston e amortizuar ose FVOCI maten me FVTPL. Një fitim ose humbje nga një investim borxhi që matet më pas me FVTPL njihet në fitim ose humbje dhe paraqitet neto brenda fitimeve/(humbjeve) të tjera në periudhën në të cilën lind. Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 nuk ka aktive financiare të klasifikuara në këtë kategori.

#### Instrumentet e kapitalit

Kompania më pas mat të gjitha investimet e kapitalit neto me vlerën e drejtë. Kur menaxhmenti i kompanisë ka zgjedhur të paraqesë fitimet dhe humbjet nga vlera e drejtë nga investimet e kapitalit neto në OCI, nuk ka riklasifikim të mëvonshëm të fitimeve dhe humbjeve nga vlera e drejtë në fitim ose humbje pas çregjistrimit të investimit. Dividentët nga investime të tilla vazhdojnë të njihen në fitim ose humbje si të ardhura nga dividentët kur vendoset e drejta e kompanisë për të marrë pagesa. Ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në FVTPL njihen në ndryshimet neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerën e drejtë, nëpërmjet fitimit ose humbjes në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas rastiit. Humbjet nga zhvlerësimi (dhe anulimi i humbjeve nga zhvlerësimi) për investimet e kapitalit të matura në FVOCI nuk raportohen veçmas nga ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë.

#### Dëmtimi

Kompania vlerëson mbi bazën e të ardhmes humbjen e pritshme të kredisë që lidhet me instrumentet e saj të borxhit të mbajtura me kosto të amortizuar dhe FVOCI. Metodologjia e aplikuar e zhvlerësimit varet nga fakti nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE – KOMPANIA  
PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË  
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025**

*(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

## 2. Politikat materiale të Kontabilitetit (Vazhdim)

### **Pasuritë dhe Paisjet**

Pasuria dhe pajisjet mbahen në koston ose koston e parapëlqyer të pakaluar me amortizimin e mbledhur dhe humbjet e akumuluar të kufizimit, nëse ka.

Amortizimi ngarkohet në bazë të drejtpërdrejtë për të shpërndarë koston ose koston e konsideruar të pasurisë dhe pajisjeve në jetë të tyre të dobishme. Më poshtë janë përlogaritjet e afërt të normave vjetore të amortizimit të aplikuar për artikujt e rëndësishëm të pasurive dhe pajisjeve:

Si në datën e bilancit	As at balance sheet date
Kompjuterët	20%
Paisje të tjera	20%
Të Paprekshmet	20%

Blerjet e mëvonshme janë përfshirë në vlerën e mbajtjes së pasurisë së asetit ose njihen si një aset i veçantë, sipas rastit, vetëm kur ka një probabilitet të përfitimeve ekonomike të ardhshme për kompaninë në lidhje me artikullin dhe kur vlera blerëse e asetit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në deklaratën e të ardhurave të përmbajtura si shpenzim gjatë periudhës financiare në të cilën janë të shpenzuar.

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

### **Qiraja**

Për çdo kontratë, Kompania merr parasysh nëse ajo është qira apo përmban qira. Një qira përkufizohet si "një kontratë, ose pjesë e një kontrate, që përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv (aktivi themelor) për një periudhë kohore në këmbim të shumës". Për të zbatuar këtë përkufizim, Kompania vlerëson nëse kontrata plotëson tre kritere kryesore, të cilat janë:

- Kontrata përmban një aset të identifikuar, i cili është ose specifikuar qartazi në kontratë ose përcaktuar në mënyrë implisite duke u identifikuar në kohën kur asetit bëhet i disponueshëm për Kompaninë
- Kompania ka të drejtën për të përfituar substancialisht të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i asetit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit, duke marrë në konsideratë të drejtat e saj të specifikuara në kontratë.
- Kompania ka të drejtën për të drejtuar përdorimin e asetit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit.
- Kompania vlerëson nëse ka të drejtën për të drejtuar 'si dhe për çfarë qëllimi' përdoret asetit gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

### **Matja dhe njohja e qirave**

Në datën e fillimit të qirasë, Kompania njeh një aktiv me të drejtën e përdorimit dhe një detyrim qiraje në bilanc. Aktivet me të drejtën e përdorimit maten me koston, e cila përfshin matjen fillestare të detyrimit të qirasë, çdo kosto të lidhur drejtpërdrejt nga Kompania, një vlerësim të çdo kostoje të çmontimit dhe heqjes në fund të qirasë dhe çdo pagesë të qirasë të bërë përpara datës së fillimit të qirasë (pato nga çdo stimulim e marrë).

Kompania më pas çregjistron aktivet me të drejtën e përdorimit duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit të qirasë deri në fundin e fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit ose afatit të qirasë. Kompania gjithashtu vlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit për zhvlerësim kur ekzistojnë tregues të zhvlerësimit.

Në datën e fillimit, Kompania mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, të skontuar duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira nëse kjo normë është lehtësisht e disponueshme, ose normën rritëse të huamarrjes së kompanisë nëse norma e nënkuptuar nuk është lehtësisht e disponueshme. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (duke përfshirë pagesat thelbësisht fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që priten të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që rrjedhin nga opsionet që janë të sigurta në mënyrë të arsyeshme për t'u ushtruar.

Pas matjes fillestare, detyrimi zvogëlohet për pagesat e kryera dhe rritet për interesin. Rivlerësohet për të pasqyruar çdo rimatje ose modifikim ose nëse ka ndryshime në pagesat thelbësisht fikse. Kur detyrimi i qirasë rivlerësohet, rregullimi përkatës pasqyrohet në aktivin e të drejtës së përdorimit, ose në fitim dhe humbje nëse aktivin me të drejtën e përdorimit është reduktuar tashmë në zero.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE – KOMPANIA  
PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË  
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025**

*(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

## **2. Politikat materiale të Kontabilitetit (Vazhdim)**

Kompania ka zgjedhur të llogarisë qiratë afatshkurtra dhe me vlerë të ulët duke përdorur një mjet praktik. Në vend të njohjes së një aktivi me të drejtën e përdorimit dhe një detyrim qiraje, pagesat që lidhen me to njihen si shpenzime në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare gjatë afatit të qirasë. Të dy aktivet me të drejtën e përdorimit dhe detyrimet e qirasë paraqiten si zëra të veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar.

### ***Amortizimi i aseteve jo financiare***

Asetet që janë nën zhvlerësim dhe amortizim shqyrtohen për kufizime çdo herë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera e mbajtjes mund të mos jetë e rikuperueshme. Vlera e mbajtjes së asetit zvogëlohet menjëherë në vlerën e tij të rikuperueshme nëse vlera e mbajtjes së asetit është më e madhe se vlera e tij e rikuperueshme e përcaktuar. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të asetit minus kostot për të shitur dhe vlera në përdorim.

### ***Tatimi***

Tatimi mbi të ardhurat llogaritet në bazë të rregullave tatimore të zbatueshme në Kosovë, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e balancës. Norma e tatimit mbi të ardhurat korporative është vendosur në 10% në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës në fuqi aktualisht, Ligji nr. 06/L-105 "Për Tatimin mbi të Ardhurat Korporative".

<b>RRITJA NETO E PARASË DHE EKVIVALENTËVE TË SAJ</b>		<b>(224,678)</b>	<b>108,496</b>
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit		399,905	282,246
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit në para dhe ekuivalentët e saj		(2,123)	9,163
<b>PARAJA DHE EKVIVALENTET E SAJ NË FUND TË VITIT</b>	<b>4</b>	<b>173,104</b>	<b>399,905</b>

Pasqyra e mësipërme e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese 1 deri më 17.

# FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 1

## Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 1. Informacione të Përgjithshme

Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tutje referuar si "Kompania") është themeluar si shoqëri aksionare më 29 Gusht 2006 me numër regjistrimi të biznesit 811280354. Kompania ka filluar veprimtarinë e saj më 4 Shtator 2006. Zyra e regjistruar ndodhet në Rr. Ukshin Hoti, nr.45/10, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Fondi 1 administrohet dhe menaxhohet nga Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve sh.a. Aksionarët kryesorë të Shoqërisë janë Prva Group PLC, e cila është themeluar në Slloveni me pronësi të 67.4% të aksioneve dhe Korporata Dukagjini në Kosovë me 32.6% të aksioneve. Kompania e fundit amë është kompania slovene Prva Finance d.o.o.

Veprimtaria kryesore e Kompanisë është skema plotësuese e pensioneve e financuar nga kontributet pensionale të punonjësve dhe punëdhënësve të tyre.

Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve sh.a.- Kompania menaxhon dhe administron Fondin 1 dhe Fondin 2. Në Fondin 1, mblidhen të gjitha kontributet nga anëtarët që nuk kanë dalë në pension, bazuar në kushtet e pensionimit të përcaktuara në Ligjin për fondet pensionale në Kosovë. Kur anëtarët dalin në pension nga Fondi 1, mjetet e tyre transferohen në Fondin 2 bazuar në shumat totale të akumuluar në llogaritë e tyre individuale. Nëse totali i mjeteve është më pak se 3,000 euro, anëtarët do të marrin mjetet si një pagesë e vetme nga Fondi 1. Nëse totali i mjeteve tejkalon shumë prej 3,000 euro, mjetet transferohen nga Fondi 1 në Fondin 2. Anëtarët pastaj do të pranojnë pagesat mujore në formë të tërheqjes në faza nga Fondi 2, duke u bazuar në planin e pagesave të Tërheqjes Fazore.

### 2. Politikat Materiale të Kontabilitetit

Politikat kryesore të kontabilitetit të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

#### **Baza e Përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") standarde të kontabilitetit të dala nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- instrumente financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL) - të matura me vlerën e drejtë;

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur politikat e kontabilitetit dhe bazat e matjes të përmbledhura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse caktohet ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF Standardet e Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabël kritike. Ai gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, monedha e Bashkimit Evropianë e cila është edhe valutë funksionale e Fondit 1.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

---

2. Politikat materiale të kontabilitetit (Vazhdim)

***Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të ndryshuara***

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme zbatohen për herë të parë për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më 1 janar 2025 ose më pas:

- Mungesa e këmbyeshmërisë (ndryshime në IAS 21), në fuqi nga 1 janari 2025.

Menaxhmenti i ka vlerësuar këto ndryshime dhe nuk ka ndikim të rëndësishëm në këto pasqyra financiare.

***Standardet dhe interpretimet e lëshuara, por ende jo në fuqi dhe që nuk janë miratuar paraprakisht***

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja dhe amendamentet ndaj standardeve ekzistuese të mëposhtme ishin lëshuar, por ende nuk kishin hyrë në fuqi:

Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7 – Klasifikimi dhe Matja e Instrumenteve Financiare, në fuqi nga 1 janari 2026.

IFRS 18 – Paraqitja dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare, në fuqi nga 1 janari 2027.

IFRS 19 – Filialet pa përgjegjësi publike: Shpalosjet, në fuqi nga 1 janari 2027..

Fondi ka zgjedhur të mos i miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave të tyre të hyrjes në fuqi. Fondi parashikon se miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Fondit gjatë periudhës së zbatimit fillestar.

# FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 1

## Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. Politikat materiale të kontabilitetit (Vazhdim)

#### **Pasuritë financiare**

##### **Klasifikimi**

Fondi klasifikon pasuritë financiare në kategorinë e mëposhtme të matjes:

- ato që do të maten më pas me vlerën e drejtë (qoftë përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse ose përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve), dhe
- ato që duhet të maten me koston e amortizuar.

Klasifikimi varet nga modeli i biznesit i njësisë ekonomike për administrimin e pasurive financiare dhe kushtet e kontratës së rrjedhës të parave.

Fondi riklasifikon investimet e borxhit kur dhe vetëm kur modeli i saj i biznesit për administrimin e atyre pasurive ndryshon.

#### **Njohja dhe mosnjohja**

Blerjet dhe shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në datën e tregtimit, datën në të cilën shoqëria angazhohet të blejë ose shet pasurinë. Mosnjohja e pasurive financiare atëherë kur të drejtat për të pranuar rrjedhën e parasë nga pasuritë financiare ka skaduar ose ato janë transferuar dhe shoqëria kryesisht ka transferuar të gjitha rreziqet nga e drejta e pronësisë.

#### **Matja**

Gjatë njohjes fillestare, Kompania mat një pasuri financiare me vlerë të saj të tregut plus, në rastin e një pasurie financiare me vlerë jo të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve (FVPL), koston e transaksionit të ndërlidhura drejtpërdrejt me blerjen e pasurisë financiare. Koston e transaksionit të pasurive financiare të mbajtura në FVPL janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Pasuritë financiare me derivativat e lidhura merren në konsideratë si tërësi, për të përcaktuar nëse rrjedhën e tyre të parasë e përbëjnë vetëm pagesa e kryejësë dhe interesit.

#### **Instrumentet e borxhit**

Matja e mëpasshme e instrumenteve të borxhit varet nga modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e pasurisë dhe karakteristikat e rrjedhjes së parasë së pasurisë. Ekzistojnë tre kategori të matjes, përmes së cilave Shoqëria i klasifikon instrumentet e saj të borxhit:

- **Kosto e amortizuar:** Pasuritë që mbahen për grumbullimin e rrjedhes së parasë kontraktuale ku ato flukse monetare përfaqësojnë vetëm pagesa të kryejësë dhe interesat maten me koston e amortizuar. Të ardhurat nga interesi nga këto pasuri financiare përfshihen në të ardhurat e financave duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja njihet drejtpërdrejt në fitim ose humbje dhe paraqitet në fitime / (humbje) të tjera së bashku me fitimet dhe humbjet në valutë. Humbjet nga zhvlerësimi paraqiten si zë i veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024, pasuri financiar me kosto të amortizuar klasifikohet në këtë kategori.
- **FVOCI:** Pasuritë që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për shitjen e pasurive financiare, ku flukset e mjeteve monetare të pasurive përfaqësojnë vetëm pagesa të kryejësë dhe interesit, maten në FVOCI. Lëvizjet në vlerën kontabël bëhen përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, përveç njohjes së fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi, të ardhurave nga interesi dhe fitimeve dhe humbjeve nga këmbimi valutor të cilat njihen në fitim ose humbje. Kur pasuria financiare çregjistrohet, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohet nga kapitali në fitim ose humbje dhe njihet në fitime / (humbje) të tjera. Të ardhurat nga interesi nga këto pasuri financiare përfshihen në të ardhurat e financave duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Fitimet dhe humbjet në valutë të huaj paraqiten në fitime / (humbje) të tjera dhe shpenzimet nga zhvlerësimi paraqiten si zë i veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 nuk ka pasuri financiare të klasifikuara në këtë kategori.
- **FVPL:** Pasuritë që nuk plotësojnë kriteret për koston e amortizuar ose FVOCI maten me FVPL. Një fitim ose humbje nga një investim borxhi që më pas matet me FVPL njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqitet neto brenda ndryshimit neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare në periudhën në të cilën ndodh. Më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024, pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve klasifikohet në këtë kategori.

## **FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 1** **Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

### **2. Politikat materiale të Kontabilitetit (Vazhdim)**

#### ***Instrumentet e Kapitalit***

Kompania më pas mat të gjitha investimet e kapitalit neto me vlerën e drejtë. Kur menaxhmenti i ndërmarrjes ka zgjedhur të paraqesë fitime dhe humbje me vlerë të drejtë nga investimet e kapitalit në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, nuk ka asnjë riklasifikim pasues të fitimeve dhe humbjeve të vlerës së drejtë në fitim ose humbje pas çregjistrimit të investimit. Dividendët nga investime të tilla vazhdojnë të njihen në fitim ose humbje si të ardhura nga dividendi kur vendoset e drejta e kompanisë për të marrë pagesa.

Ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në FVPL njihen në ndryshimet Neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerë të drejtë, përmes fitimit ose humbjes në pasqyrën e fitimit ose humbjes, siç zbatohet. Humbjet nga zhvlerësimi (dhe kthimi i humbjeve nga zhvlerësimi) në investimet e kapitalit të matura në FVOCI nuk raportohen veçmas nga ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë.

#### ***Zhvlerësimi***

Kompania vlerëson mbi një bazë të ardhme humbjen e pritshme të kredisë lidhur me instrumentet e saj të borxhit të bartura me kosto të amortizuar dhe FVOCI. Metodologjia e zhvlerësimit e aplikuar varet nga fakti nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë.

#### ***Paraja dhe ekuivalentët e saj***

Paratë dhe ekuivalentët e saj, që përmbajnë bilancet me bankat për pagesa të kontributeve të pensioneve dhe për qëllime investimesh, mbahen me kosto.

#### ***Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet në lidhje me letrat me vlerë të investimeve***

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet ndodhin nga blerja dhe shitja e investimeve dhe njihen si pasuri dhe / ose detyrime në datën e transaksionit të bërë.

#### ***Neto pasuritë e Fondit 1***

Vlera neto e pasurive të Fondit është e barabartë me gjithsej pasuritë minus gjithsej detyrimet e Fondit 1.

#### ***Detyrimet financiare***

Matja pasuese e detyrimeve financiare varet nga mënyra se si ato janë kategorizuar në njohjen fillestare. Fondi klasifikon detyrimet financiare në detyrimet e tjera financiare.

Matja pasuese e detyrimeve financiare varet nga mënyra se si ato janë kategorizuar në njohjen fillestare. Fondi klasifikon detyrimet financiare në detyrimet e tjera financiare.

Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

#### ***Vlera e njësisë së kontabilitetit***

Vlera e njësisë kontabël është e barabartë me vlerën e mjeteve neto të Fondit të ndarë me numrin gjithsej të njësisë kontabël që nga data e llogaritjes. Kjo formulë nuk zbatohet që nga dita e parë e operacioneve kur vlera e njësisë kontabël është e barabartë me 100 Euro në përputhje me politikën e Fondit.

#### ***Të hyrat nga interesi***

Të hyrat nga interesi përfshijnë të ardhurat nga normat e kuponëve të obligacioneve dhe interesit mbi depozitat me afat. Të hyrat e interesit janë regjistruar në bazë akruale.

#### ***Të hyrat nga dividenda***

Dividentat njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse atëherë kur përcaktohet e drejta e Fondit për të pranuar pagesën.

#### ***Tarifa e menaxhimit***

Fondi 1 është i obliguar të paguajë tarifën e menaxhimit kompanisë në baza mujore. Tarifa vjetore e menaxhimit është 1.5% e gjithsej pasurive të Fondit.

#### ***Shpenzimet për tarifën e transaksionit***

Këto shpenzime lidhen me tarifën e paguar ndërmjetësuesve financiar (bankave dhe komisionerëve) të cilët blejnë investime për Fondin 1.

## **FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - FOND 1** **Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

### 2. Politikat materiale të Kontabilitetit (Vazhdim)

#### **Fitimet / humbjet e realizuara**

Fitimet / humbjet e realizuara vijnë nga shitja e investimeve, niveli i çmimeve kur investimet merren dhe kapitali i maturuar dhe interesi i investimeve të blera me premium ose zbritje. Këto fitime / humbje regjistrohen të realizuara në pasqyrën e fitimit dhe humbjes së linjës Ndryshimet neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerë të drejtë, përmes fitimit ose humbjes.

Fitimet ose humbjet që vijnë kur shitjet ose maturimet e investimeve paraqiten si "Të Realizuara" në pasqyrën e të ardhurave, ndërsa fitimet ose humbjet që vijnë nga vlerësimi i investimeve ende të mbajtura paraqiten veçmas si "Të përealizuara" në Ndryshimet Netto në vlerën e drejtë të pasurive financiare me vlerën e drejtë, përmes fitimit ose humbjes.

#### **Amortizimi i zbritjes/primit i letrës me vlerë**

Amortizimi i zbritjes/primit të letrës me vlerë është regjistruar përmes të ardhurave/shpenzimeve të shtyra dhe shpenzimeve/të ardhurave akruale. Në momentin kur letra me vlerë është maturuar apo shitur, shumat e amortizuara është transferuar si fitim ose humbje e realizuar kapitale.

#### **Fitimet / humbja nga këmbimi valutor**

Transaksionet në valutën e huaj janë regjistruar në pajtueshmëri me normat e vlefshme të këmbimit valutor në datën e transaksionit. Diferencat janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si fitime/humbje.

Diferencat e këmbimit valutor të cilat rrjedhin nga raportimi në datën e vlerësimit të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj dhe diferencës që rrjedhë nga shitja e investimeve, raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të realizuara". Diferencat e këmbimit valutor të cilat rrjedhin nga raportimi në datën e përkthimit të investimeve të mbajtura, raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të përealizuara"

#### **Transaksionet me palët e ndërlidhura**

Palët e ndërlidhura përcaktohen si ato palë që kanë kontroll mbi njëra-tjetrën ose kanë një ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëra-tjetrës.

Palët e ndërlidhura me Fondin janë Prva Company PLC nga Ljubljana, Sllovenia dhe Corporation Dukagjini nga Peja, Republika e Kosovës.

### 3. Vlerësimet dhe supozimet kritike të kontabilitetit

#### **Vlera e drejtë e letrave me vlerë të pakuotuar në tregun aktiv**

Vlera e drejtë e letrave me vlerë të tilla të pakuotuar në një treg aktiv mund të përcaktohet nga kompania duke përdorur burime të besueshme të çmimeve ose çmime treguese nga obligacionet/borxhet e tregut.

Kompania do të ushtrojë gjykimin dhe vlerësimet lidhur me sasinë dhe cilësinë e burimeve të çmimeve të përdorura. Kur nuk ka të dhëna në treg, Kompania mund të vë çmim për pozicionet e saj duke përdorur modelet e veta, të cilat zakonisht janë të bazuara në metoda të vlerësimit dhe teknikat të njohura përgjithësisht si standarde brenda industrisë. Hyrjet në këto modele janë kryesisht rendimente të letrave me vlerë dhe rrjedhje të zbritura të parasë. Modelet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta janë të vlefshme dhe të rishikuara në mënyrë periodike nga menaxhmenti.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**4. Paraja dhe Ekuivalentët e Saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë të mbajtura në llogarinë rrjedhëse në bankat komerciale.

**5. Pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve**

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrat e pozicioneve financiare janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Obligacionet e korporatave	264,353	316,402
Obligacionet qeveritare	1,531,936	1,403,793
Letra me vlerë të ekuitetit	8,451,944	7,728,905
<b>GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE NË FVPL</b>	<b>10,248,233</b>	<b>9,449,099</b>

Letrat me vlerë të ekuitetit përbëhen nga investimi në aksionet e listuara (Fondet e Tregtuara në Bursa). Struktura e portofolit të ekuitetit sipas rajonit është e paraqitur në tabelën vijuese:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Bashkimi Evropian	3,029,927	3,050,664
Tregjet në zhvillim	998,714	830,914
Japoni dhe Paqësor	433,708	476,351
Amerikë e Veriut	3,989,595	3,370,976
<b>GJITHSEJ LETRAT ME VLERË TË EKUITETIT</b>	<b>8,451,944</b>	<b>7,728,905</b>

Lidhur me cilësinë e obligacioneve dhe bonove të thesarit referojuni shënimit 14 Menaxhimi i Riskut Financiar.

**6. Pasuritë financiare me kosto të amortizuar**

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Depozitat në banka	250,000	150,000
Interesi i përlogaritur	3,450	1,243
Zhvlerësimet e lejuara	(1,251)	(747)
<b>GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE ME KOSTO TË AMORTIZUAR</b>	<b>252,199</b>	<b>150,496</b>

Depozitat në Bankën Kombëtare Tregtare fitojnë interes prej 2.1% deri në 2.75% (2024: 2.1% dhe 2.25%) në bazë vjetore.

Ndarja e Pasurive Financiare Rrjedhëse dhe Jo-Rrjedhëse më 31 Dhjetor 2025:

<u>Përshkrimi</u>	<u>Data e maturimit</u>	<u>Shuma (euro)</u>	<u>Klasifikimi</u>
Depozita me afat	Korrik 2026	100,000	Afatshkurtër
Depozita me afat	Tetor 2026	50,000	Afatshkurtër
Depozita me afat	Shkurt 2027	50,000	Afatgjatë
Depozita me afat	Tetor 2027	50,000	Afatgjatë

Ndarja e Pasurive Financiare Rrjedhëse dhe Jo-Rrjedhëse më 31 Dhjetor 2024

<u>Përshkrimi</u>	<u>Data e maturimit</u>	<u>Shuma (euro)</u>	<u>Klasifikimi</u>
Depozita me afat	Korrik 2026	100,000	Afatshkurtër
Depozita me afat	Tetor 2026	50,000	Afatshkurtër

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**7. Detyrimet për ndarjen e fitimit**

Kompania ka shpërblyer menaxherin e aseteve në bazë të planit pensional “Në rast se fondi funksionon më mirë se standardi i përcaktuar në aktin e brendshëm, atëherë menaxheri i aseteve ka të drejtë një shpërblim deri në 20% të kthimit mbi atë pikë referimi”. Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2025, kthimi i synuar i synuar nuk është arritur dhe fondi nuk ka njohur asnjë detyrim për ndarjen e fitimit. Kthimi i fondit vendoset çdo vit më 30 nëntor. Plani pensional i Kompanisë për kthimin e mjeteve miratohet nga Banka Qendrore. Kthimi i Fondit 1 nga nëntori 2024 deri në nëntor 2025 ishte 2.63% dhe kthimi nga standardi i përcaktuar ishte 3.19%, rrjedhimisht menaxheri i aseteve nuk kishte të drejtë për shpërblimin e tij prej 20% të diferencës midis kthimit aktual dhe kthimit standard për vitin e mbyllur 2025. Ndërsa për vitin 2024, kthimi i Fondit ka tejkaluar benchmark-un e aplikueshëm; si rrjedhojë, Menaxheri i Aseteve fitoi të drejtën për një shpërblim performance prej 20%, në shumën 219,513 EUR. Shpenzimi dhe detyrimi përkatës janë njohur në pasqyrat financiare të vitit 2024.

**8. Detyrimet tjera**

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Detyrimet për riblerjen e njësive llogaritëse	2,022	6,129
<b>GJITHSEJ DETYRIMET TJERA</b>	<b>2,022</b>	<b>6,129</b>

**9. Të hyrat nga interesi**

	2025	2024
Të hyrat nga interesi i letrave me vlerë në FVPL	65,455	51,497
Të hyrat e interesit nga letrat me vlerë me kosto të amortizuar	4,448	3,198
<b>GJITHSEJ TË HYRA NGA INTERESI</b>	<b>69,903</b>	<b>54,695</b>

**10. Ndryshimet neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve**

	2025	2024
<b>Fitimi (Humbja) e realizuar</b>		
Obligacionet qeveritare	2,587	(3,800)
Obligacionet e korporatave	-	1,556
Letrat me vlerë të ekuitetit	53,133	66,708
<b>Gjithsej Fitimi (Humbja) e Realizuar</b>	<b>55,720</b>	<b>64,464</b>
<b>Fitimi (Humbja) e Perealizuar</b>		
Obligacionet e korporatave	(52,049)	24,808
Obligacionet qeveritare	4,560	2,588
Letrat me vlerë të ekuitetit	918,630	776,919
<b>Gjithsej Fitimi (Humbja) e Perealizuar</b>	<b>871,141</b>	<b>804,315</b>
<b>NETO NDRYSHIMET NË VLERËN E DREJTË TË PASURIVE FINANCIARE NË FVPL</b>	<b>926,861</b>	<b>868,779</b>

**11. Fitimi (Humbja) nga këmbimi valutor**

Fitimi në valutë, neto është si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit për aktivet e shprehura në USD. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur fitimi ose humbja e realizuar dhe e perealizuar:

	2025	2024
Fitimi (Humbja) e Realizuar	(3,566)	13,074
Fitimi (Humbja) e Perealizuar	(431,009)	181,299
<b>GJITHSEJ FITIMI/HUMBJA NGA KËMBIMEVET VALUTORE</b>	<b>(434,575)</b>	<b>194,373</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**12. Transaksionet me palët e ndërlidhura**

Palët e ndërlidhura përfshijnë aksionarët kryesorë të Kompanisë, filialet dhe entitetet nën pronësi të përbashkët, kontrolli dhe menaxhimi i përbashkët i Fondit, ose aktivitetet mbi të cilat Kompania ka aftësi për të ushtruar kontrollë.

Të gjitha transaksionet e Kompanisë me palët e lidhura dalin nga rrjedha normale e biznesit dhe vlera e tyre nuk është materialisht e ndryshme nga afatet dhe kushtet që do të zotëronin në transaksione të vullnetit të lirë. Të gjitha transaksionet dhe bilancet e palëve të lidhura dhe balancat i referohen Kompanisë, FSKP-së dhe menaxherit të pasurive, dhe janë si në vijim:

31 Dhjetor 2025	Prva Kompania	Kompania	Fond 2	Gjithsej
Të arkëtueshmet	-	-	-	-
Të arkëtueshmet nga kompania	-	205	-	205
<b>Gjithsej të Arkëtueshmet</b>	-	<b>205</b>	-	<b>205</b>
Detyrimet	-	-	-	-
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	(15,486)	-	(15,486)
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	-	-
<b>Gjithsej Detyrimet</b>	-	<b>(15,486)</b>	-	<b>(15,486)</b>
Shpenzimet				
Shpenzimet për tarifën e menaxhimit	-	(152,228)	-	(152,228)
Shpenzimet e tarifës dalëse	-	(3,846)	-	(3,846)
Shpenzimet e tarifës yrëse	-	(23,202)	-	(23,202)
<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	-	<b>(179,276)</b>	-	<b>(179,276)</b>
31 Dhjetor 2024	Prva Kompania	Kompania	Fond 2	Gjithsej
Të arkëtueshmet	-	-	-	-
Të arkëtueshmet nga kompania	-	198	-	198
<b>Gjithsej të Arkëtueshmet</b>	-	<b>198</b>	-	<b>198</b>
Detyrimet	-	-	-	-
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	(14,698)	-	(14,698)
Detyrimet për ndarjen e fitimit	(219,513)	-	-	(219,513)
<b>Gjithsej Detyrimet</b>	<b>(219,513)</b>	<b>(14,698)</b>	-	<b>(234,211)</b>
Shpenzimet për ndarjen e fitimit	(219,513)	-	-	(219,513)
Shpenzimet për tarifë e menaxhimit	-	(141,175)	-	(141,175)
Shpenzimet për tarifën dalëse	-	(4,726)	-	(4,726)
Shpenzimet për tarifën hyrëse	-	(20,017)	-	(20,017)
<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	<b>(219,513)</b>	<b>(165,918)</b>	-	<b>(385,431)</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**13. Instrumentet financiare sipas kategorisë**

Vlerat bartëse të pasurive financiare dhe detyrimeve të shoqërisë siç janë njohur në datën e pasqyrave të pozicionit financiar nën rishikim mundën gjithashtu të kategorizohen si në vazhdim:

	Në vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	Me kosto të amortizuar	Gjithsej
31 Dhjetor 2025			
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	173,104	173,104
Pasuritë Financiare në FVPL	10,248,233	-	10,248,233
Pasuritë financiare me koston e amortizuar	-	252,199	252,199
Të arkëtueshmet e tjera	-	2,324	2,324
<b>GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE</b>	<b>10,248,233</b>	<b>427,627</b>	<b>10,675,860</b>

	Në vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	Me kosto të amortizuar	Gjithsej
31 Dhjetor 2025			
Detyrimet			
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	-
Detyrimet për tarifën menaxhimit	-	15,486	15,486
Detyrimet tjera	-	2,022	2,022
<b>GJITHSEJ DETYRIMET FINANCIARE</b>	<b>-</b>	<b>17,508</b>	<b>17,508</b>

	Në vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	Me kosto të amortizuar	Gjithsej
31 Dhjetor 2024			
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	399,905	399,905
Pasuritë Financiare në FVPL	9,449,099	-	9,449,099
Pasuritë financiare me koston e amortizuar	-	150,496	150,496
Të arkëtueshmet e tjera	-	1,751	1,751
<b>GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE</b>	<b>9,449,099</b>	<b>552,152</b>	<b>10,001,251</b>

	Në vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	Me kosto të amortizuar	Gjithsej
31 Dhjetor 2024			
Detyrimet			
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	219,513	219,513
Detyrimet për tarifën menaxhimit	-	14,698	14,698
Detyrimet tjera	-	6,129	6,129
<b>GJITHSEJ PASURITË FINANCIARE</b>	<b>-</b>	<b>240,340</b>	<b>240,340</b>

# FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1

## Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 14. Menaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e Fondit janë të ekspozuara ndaj një shumëllojshmërie të risqeve financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e risqeve. Qëllimi i Fondit është që të arrihet një balancë e përshtatshme në mes të rrezikut dhe kthimit për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi punën financiare të Fondit.

Politikat e menaxhimit të riskut të Kompanisë janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar këto rreziqe, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura të riskut dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve nëpërmjet sistemeve të besueshme dhe të përditësuar të informacionit.

Menaxhmenti i Kompanisë rregullisht rishikon politikat e saj të menaxhimit të riskut dhe sistemet për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikat më të mira në zhvillim.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga departamenti i menaxhimit të riskut të Kompanisë, sipas politikave të miratuara nga ajo. Ky departament identifikon dhe vlerëson rreziqet financiare në bashkëpunim të ngushtë me njësitë operative të Kompanisë. Kompania siguron politika dhe procedura të shkruara për menaxhimin e riskut të përgjithshëm, si dhe politika të shkruara të cilat mbulojnë fusha specifike, të tilla sikurse risku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit dhe risku kreditor.

### Rreziku kreditor

#### *Pasuritë financiare me kosto të amortizuar*

Fondi merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë kundërvepruese do të shkaktojë një humbje financiare për Fondin duke mos përmbushur një detyrim. Rreziku i kredisë është rreziku më i rëndësishëm për aktivitetet e biznesit të Fondit. Prandaj, menaxhmenti i Fondit menaxhon me kujdes ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë. Fondi duhet të jetë në përputhje me rregullat e BQK-së në lidhje me llojet, shumat e investimeve në asetet financiare.

Investimet e borxhit me kosto të amortizuar përbëhen nga depozita me afat në Bankën Kombëtare Tregtare. Parashikimi i humbjeve për investimet me kosto të amortizuar njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe humbjeve.

Lëvizja në provizionet e humbjeve për investimet financiare me kosto të amortizuara është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Zhvlerësimet e lejuara	2025	2024
Bilanci fillestar	747	651
Rritja e lirimt të humbjes së huasë e njohur në fitim ose humbje gjatë vitit	504	95
<b>Mbyllja e lejimit të humbjes më 31 Dhjetor</b>	<b>1,251</b>	<b>746</b>

Llogaritja e kompensimeve për dëmtime bëhet në bazë të vlerësimit të kredisë të kompanisë së fundit amë të Bankës Kombëtare Tregtare, Calik Holding.

Më 31 Dhjetor 2025 faktori i mëposhtëm i rrezikut ishte duke përdorur për llogaritjen e dëmtimit:

Klasifikimi	Probabiliteti i mos pagesës	Humbja nga mos pagesat
<b>BB</b>	<b>0.900%</b>	<b>56,10%</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**14. Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)**

*Pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes*

Entiteti është ekspozuar gjithashtu ndaj rrezikut kreditor lidhur me investimet e borxhit të cilat maten me vlerë të tregut nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Ekspozimi maksimal në fund të periudhës raportuese është vlera bartëse e këtyre investimeve.

<b>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë</b>	<b>31 Dhjetor 2025</b>	<b>31 Dhjetor 2024</b>
Obligacionet e korporatave	264,353	316,402
Obligacionet qeveritare	1,531,936	1,403,793
Paraja dhe ekuivalentët e saj	173,104	399,902
Të arkëtueshmet tjera	2,324	1,751
<b>EKSPOZIMI MAKSIMAL NDAJ RREZIKUT TË KREDISË</b>	<b>1,971,717</b>	<b>2,121,851</b>

Tek tabela e mëposhtme është paraqitur struktura e portofolit sipas klasifikimit:

<b>Klasifikimi</b>	<b>31 Dhjetor 2025</b>	<b>31 Dhjetor 2024</b>
A+	101,361	101,215
BBB- to B-	139,993	138,041
BB-	1,391,943	1,265,752
E pa vlerësuar	162,992	215,187
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1,796,289</b>	<b>1,720,195</b>

Tek tabela e mëposhtme është paraqitur struktura e portofolit sipas rajonit:

<b>Rajoni</b>	<b>31 Dhjetor 2025</b>	<b>31 Dhjetor 2024</b>
Ballkani - Kosovë	1,391,943	1,265,752
Bashkimi Evropian	302,985	353,228
Lindja e Mesme	101,361	101,215
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1,796,289</b>	<b>1,720,195</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**14. Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)**

**Rreziku i normës së interesit**

Tabela më poshtë analizon pasuritë dhe detyrimet e Fondit në maturimin përkatës bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit deri në datën e maturimit kontraktual më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024:

31 Dhjetor 2025	Që bartin interes						Gjithsej
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk bartin interes	
<b>Pasuritë</b>							
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	-	-	-	-	173,104	173,104
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	-	-	535,619	918,980	341,689	8,451,944	10,248,233
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	-	-	152,801	100,650	-	-	253,451
Të arkëtueshmet tjera	-	-	-	-	-	2,324	2,324
<b>Gjithsej Pasuritë Financiare</b>	-	-	<b>688,420</b>	<b>1,019,630</b>	<b>341,689</b>	<b>8,627,372</b>	<b>10,677,111</b>
<b>Detyrimet</b>							
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	-	-	-	-	-
Detyrimet për tarifën menaxhimit	-	-	-	-	-	15,486	15,486
Detyrimet tjera	-	-	-	-	-	2,022	2,022
<b>Gjithsej Detyrimet Financiare</b>	-	-	-	-	-	<b>17,508</b>	<b>17,508</b>
<b>Hendeku në neto riskun e interesit</b>	-	-	<b>687,169</b>	<b>1,019,630</b>	<b>341,689</b>	<b>8,609,864</b>	<b>10,658,352</b>

31 Dhjetor 2024	Që bartin interes						Gjithsej
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk bartin interes	
<b>Pasuritë</b>							
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	-	-	-	-	399,905	399,905
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	-	-	300,447	1,390,739	28,889	7,729,024	9,449,099
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	-	-	-	151,243	-	-	151,243
Të arkëtueshmet tjera	-	-	-	-	-	1,751	1,751
<b>Gjithsej Pasuritë Financiare</b>	-	-	<b>300,447</b>	<b>1,541,982</b>	<b>28,889</b>	<b>8,130,680</b>	<b>10,001,998</b>
<b>Detyrimet</b>							
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	-	-	-	219,513	219,513
Detyrimet për tarifën menaxhimit	-	-	-	-	-	14,698	14,698
Detyrimet tjera	-	-	-	-	-	6,129	6,129
<b>Gjithsej Detyrimet Financiare</b>	-	-	-	-	-	<b>240,340</b>	<b>240,340</b>
<b>Hendeku në neto riskun e interesit</b>	-	-	<b>300,447</b>	<b>1,541,235</b>	<b>28,889</b>	<b>7,890,340</b>	<b>9,760,911</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**14. Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)**

Një analizë e ndjeshmërisë së Kompanisë ndaj një rritjeje ose uljeje të normave të interesit në treg (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike në kurbat e kthimit dhe se pozicioni financiar mbetet i pandryshuar) është si më poshtë:

2025	Skenarë deri në 1 vit		Skenarë mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
Efekti i Fitimit (humbjes) së Vlerësuar	(37,319)	37,319	(175,873)	175,873
2024	Skenarë deri në 1 vit		Skenarë mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
Efekti i Fitimit (humbjes) së Vlerësuar	(40,075)	40,075	(155,158)	155,158

**Rreziku i monedhës së huaj**

Fondi 1 i është ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës së huaj, si pasojë e rrjedhave në nivelin e kursit të këmbimit. Tabelat e mëposhtme përmbledhin pozicionin e pasurive dhe detyrimeve monetare të Fondit më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024:

31 Dhjetor 2025	në EUR	në USD	Gjithsej
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	115,233	57,871	173,104
Pasuria financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave	6,135,318	4,112,915	10,248,233
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	252,199	-	252,199
Të arkëtueshmet tjera	374	1,950	2,324
<b>Gjithsej Pasuritë Financiare</b>	<b>6,503,124</b>	<b>4,172,736</b>	<b>10,675,860</b>
Detyrimet			
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	15,486	-	15,486
Detyrime të tjera	2,022	-	2,022
<b>Gjithsej Detyrimet Financiare</b>	<b>17,508</b>	<b>-</b>	<b>17,508</b>
<b>Rreziku neto i valutës</b>	<b>6,485,616</b>	<b>4,172,736</b>	<b>10,658,352</b>
31 Dhjetor 2024			
Gjithsej pasuritë financiare	6,236,785	3,764,466	10,001,251
Gjithsej detyrimet financiare	240,340	-	240,340
<b>Rreziku neto i valutës</b>	<b>5,996,446</b>	<b>3,764,466</b>	<b>9,760,911</b>

Një analizë e ndjeshmërisë së Kompanisë ndaj një rritjeje ose uljeje të normave të këmbimit valutor është si më poshtë:

	USD	
	2025	2024
Normat e ndjeshmërisë		
Fitim ise humbje		
+5% për USD	208,637	188,223
- 5% për USD	(208,637)	(188,223)

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**14. Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)**

**Rreziku i likuiditetit**

Politika e Fondit 1 është të investoj pasuritë në instrumente financiare me likuiditet në tregjet e ndryshme të kapitalit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar me ligj dhe rregullore. Në procesin e krijimit të portofolit të Fondit, me qëllim sigurimin e një likuiditeti më të lartë, pasuritë e Fondit u investuan në investime të karakterizuara me mundësi të shndërrimit të shpejtë në para dhe ekuivalentë të parave të gatshme. Tabelat më poshtë analizojnë pasuritë dhe detyrimet e Fondit në maturimin përkatës bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit deri në datën e maturimit kontraktor (në Euro).

31 Dhjetor 2025	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Pa Maturitet	Gjithsej
Paraja dhe ekuivalentët e saj	173,104	-	-	-	-	-	173,104
FVPL	-	-	535,619	918,980	341,689	8,451,944	10,248,233
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	-	-	152,801	100,650	-	-	253,451
Të arkëtueshmet tjera	2,324	-	-	-	-	-	2,324
<b>Gjithsej Pasuritë Financiare</b>	<b>175,428</b>	<b>-</b>	<b>688,420</b>	<b>1,019,630</b>	<b>341,689</b>	<b>8,451,944</b>	<b>10,677,111</b>
Detyrimet							
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	15,486	-	-	-	-	-	15,486
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	2,022	-	-	-	-	-	2,022
<b>Gjithsej Detyrimet Financiare</b>	<b>17,508</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>17,508</b>
<b>Rreziku neto i likuiditetit</b>	<b>157,920</b>	<b>-</b>	<b>688,420</b>	<b>1,019,630</b>	<b>341,689</b>	<b>8,451,944</b>	<b>10,659,603</b>
31 Dhjetor 2024							
Gjithsej pasuritë	401,656	-	300,447	1,541,982	29,008	7,728,905	10,001,998
Gjithsej detyrimet	240,340	-	-	-	-	-	240,340
<b>Rreziku neto i likuiditetit</b>	<b>161,316</b>	<b>-</b>	<b>300,447</b>	<b>1,541,982</b>	<b>29,008</b>	<b>7,728,905</b>	<b>9,761,658</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA- FUND 1**  
**Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025**  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**15. Vlerat e drejta**

Vlera e drejtë përfaqëson shumën me të cilën një pasuri mund të zëvendësohet, ose një detyrim të shlyhet në një transaksion duar lirë. Vlera e drejtë është bazuar në supozimet e menaxhmentit, sipas fitimit të pasurisë dhe bazës së detyrimit.

Instrumentet financiare të prezantuara me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të llogaritura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhshmëri me hierarkinë e vlerës së drejtë janë të paraqitura në tabelën vijuese. Kjo hierarki në Kompani mbledh pasuritë financiare dhe detyrimet në tri nivele të cilat bazohen në rëndësinë e të dhënave të ardhura, të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë identike ose detyrimet;
- Niveli 2: të dhënat hyrëse të tjera, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë të gatshme për vëzhgim të pasurisë ose të detyrimit, në mënyrë direkte (p.sh. Çmimet) ose indirekte (p.sh. të bëra nga çmimet);
- Niveli 3: të dhënat hyrëse në pasuri ose detyrim të cilat nuk bazohen në të dhëna të gatshme për vëzhgim të tregut.

Pasuritë financiare të cilat maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e neto pasurisë së Fondit 1, janë grupuar sipas nivelit të hierarkisë të vlerës së drejtë, si në vazhdim (në Euro).

31 Dhjetor 2025	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Pasuritë	8,856,290	1,391,943	-	10,248,233
<b>Pasuritë Financiare FVPL</b>	<b>8,856,290</b>	<b>1,391,943</b>	<b>-</b>	<b>10,248,233</b>

31 Dhjetor 2024	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Pasuritë	8,183,348	1,265,752	-	9,449,099
<b>Pasuritë Financiare FVPL</b>	<b>8,183,348</b>	<b>1,265,752</b>	<b>-</b>	<b>9,449,099</b>

Tabela në vijim përmbledh vlerat bartëse dhe vlerat e drejta të atyre pasurive dhe detyrimeve financiare të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera bartëse		Vlera e drejtë	
	2025	2024	2025	2024
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	173,104	399,905	173,104	399,905
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	252,199	150,496	252,199	150,496
Të arkëtueshmet tjera	2,324	1,751	2,324	1,751
<b>Gjithsej Pasuritë</b>	<b>427,627</b>	<b>552,152</b>	<b>427,627</b>	<b>552,152</b>
Detyrimet				
Detyrimet e tarifës së menaxhimit dhe detyrimet tjera	17,508	240,341	17,508	240,341
<b>Gjithsej Detyrimet</b>	<b>17,508</b>	<b>240,341</b>	<b>17,508</b>	<b>240,341</b>

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në tregje aktive (siç janë letrat me vlerë të tregtueshme dhe në dispozicion për shitje) është e bazuar në çmimet e kuotuar të tregut në datën e pozicionit. Çmimi i kuotuar i tregut i përdorur për pasuritë financiare të mbajtura nga Fondi është çmimi aktual i ofertimit.

Vlera reale e instrumenteve financiare që nuk janë tregtuar në tregje aktive është përcaktuar duke përdorur teknikat e vlerësimit.

Vlera bartëse minus provizioni për dëmtimin e të arkëtueshmeve tregtare si dhe vlera bartëse e të pagueshmeve supozohet se përfaqëson vlerat e tyre reale. Vlera reale e detyrimeve financiare për qëllime të shpalljes është vlerësuar duke zbritur rrjedhat e ardhshme të parasë së kontraktuar në normën e interesit aktual në treg që është në dispozicion të Fondit për instrumente të ngjashme financiare. Megjithatë, për vendosjet bankare afatshkurtra, ku normat e interesit janë të krahasueshme në treg, vlera kontabël është konsideruar të jetë përafërimi më i mirë e vlerës së drejtë.

## **16. Kontigjencat dhe angazhimet**

### *Kontestet gjyqësore*

Më 31 dhjetor 2025 nuk ka pasur provizione për humbje të mundshme lidhur me kontestet gjyqësore, pasi nuk ka raste ligjore kundër Kompanisë. Menaxhmenti i Kompanisë analizon rregullisht rreziqet e mundshme që rrjedhin nga humbjet në procedurat ligjore dhe nga kërkesat e mundshme ndaj Kompanisë, të cilat mund të lindin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të përcaktohet gjithmonë me saktësi, menaxhmenti i Kompanisë beson se nuk pritet të rezultojnë detyrime materiale.

### *Tatimet*

Librat dhe evidencat tatimore të Kompanisë nuk janë inspektuar nga autoritetet tatimore lokale gjatë viteve 2025 dhe 2024. Autoritetet tatimore të Republikës së Kosovës janë të autorizuar të kryejnë ekzaminime individuale të deklaratave tatimore. Si rrjedhojë, detyrimet tatimore të Kompanisë nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Tatimet shtesë që mund të lindin në rast të një kontrolli tatimor nuk mund të përcaktohen me saktësi të arsyeshme. Megjithatë, Kompania ka ndjekur të gjitha rregullat dhe rregulloret tatimore gjatë llogaritjes së detyrimeve tatimore.

## **17. Ngjarjet pas datës së raportimit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së raportimit deri në miratimin e këtyre pasqyrave financiare që do të kërkonin rregullime, ose shpallorje shtesë në këto pasqyra financiare.

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve

Fondi 2

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

## Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në neto pasuritë	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimet për pasqyrat financiare	7-19

# Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Aksionarët e

Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. – Fondi 2

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a.- Fondi 2 (“Fondi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në pasuritë neto dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave materiale të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me IFRS-të, Standardet e kontabilitetit siç janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

## Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë të sqaruara më tutje në seksionin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante në Kosovë për auditimin tonë të pasqyrave financiare dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit të BSNEK-së. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të, Standardet e kontabilitetit siç janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë më vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

## Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare


